



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 9 datë 10/05/2016

Për miratimin e projektit : “Përmirësimi i menaxhimit të ujit të pijshëm dhe infrastrukturës së furnizimit me ujë përmes përdorimit të teknologjive “smart”, politikave dhe instrumenteve SAVE-WATER ”

Këshilli Qarkut Vlorë, i mbledhur sot më dt 10/05/2016 në zbatim të nenit 34 dhe nenit 77, të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ dhe udhëzimit Nr .8 pika 3 të Ministrisë së Financave datë 17.02.2003 “ Per Evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financave të huaja“ Ligji Nr. 9840, datë 10.12.2007 për Ratifikimin e “Marrëveshjes Kuadër Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për Rregullat e Bashkëpunimit për Asistencën për Shqipërinë, në Kuadër të Zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”. Ligji nr.10332, datë 14.10.2010, për Ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, për vitin 2009”, të Komponentit të dytë të Instrumentit të Ndhmës së Paraaderimit (IPA) – Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë , Fletore Zyrtare nr. 149, datë 08.11.2010, hyrja në fuqi: 23.11.2010, pasi mori në shqyrtim projektin e paraqitur nga Zedhenesja e Kryetarit dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin “Përmirësimi i menaxhimit të ujit të pijshëm dhe infrastrukturës së furnizimit me ujë përmes përdorimit të teknologjive “smart”, politikave dhe instrumenteve SAVE-WATER” me 8 partnerët ndërkufitare (Rajoni i Ishujve Joniane, Rajoni i Epirit, Qendra Ambientale në Rajonin e Maqedonisë Perëndimore, Bashkia e Janinës, Universiteti i Janinës, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Maqedoninë Perëndimore për palën greke dhe Qarku i Vlorës dhe Qarku i Korçës për palen shqiptare) në kuadër të Programit Ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri 2014-2020 projekt Strategjik në partneritet të plotë me partnerët lokalë.
2. Vlera totale e projektit “Përmirësimi i menaxhimit të ujit të pijshëm dhe infrastrukturës së furnizimit me ujë përmes përdorimit të teknologjive “smart”, politikave dhe instrumenteve SAVE-WATER” bashkë me vlerat e bashkëfinancimit është **530.000 Euro** nga ku vlera e bashkëfinancimit si kontribut i Këshillit të Qarkut është parashikuar në masën 15%.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr: _____

prot. dt. 10/05/2016